Vendim nr. 283, datë 31.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 31.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 39 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:	**ARTUR BEJLERAJ**
OBJEKTI:	**Shfuqizimi i vendimeve nr. 2208, datë 20.12.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-1842, datë 02.12.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
BAZA LIGJORE:	**Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është administrator i shoqërisë "Bejleraj" sh.p.k., me qendër në Tiranë. Në vitet 2006 dhe 2008 ka marrë kredi bankare në bankën Credins sh.a.*(banka)* për shlyerjen e të cilave ka qenë dorëzanës vetë ai dhe babai i tij, shtetasi S.B., i cili ka vënë si garanci një pasuri të paluajtshme tokë që ndodhej në Patos Fshat në qytetin e Fierit. Për shkak të mosshlyerjes në kohë të kredisë, banka i është drejtuar shoqërisë përmbarimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k. (BSA) me qendër në Tiranë.

2. Sipas kërkuesit, përmbaruesi gjyqësor, drejtori i bankës dhe përgjegjësi i sektorit të kredive në bankë, gjatë vënies në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit për kreditë, kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të tij e të shoqërisë ku ai është administrator, si dhe nuk është njoftuar më herët nga banka. Në këto rrethana, kërkuesi, në datën 02.09.2017, ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Prokuroria ka regjistruar kallëzimin penal nr. 1119 të vitit 2017 *(procedimi penal nr. 1119/2017)* për veprat penale "Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën", të parashikuar në nenin 135 të Kodit Penal *(KP),* "Falsifikimi i dokumenteve", të parashikuar në nenin 186 të KP-së dhe "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar në nenin 248 të KP-së.

3. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në përfundim të hetimeve paraprake ka dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. 1119/2017, e cila, me vendimin nr. 16, datë 15.01.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim kërkuesi. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.129, datë 26.02.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.16, datë 15.01.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe rrëzimin e kërkesës, pasi ka konsideruar se hetimet ishin të pamjaftueshme, kryesisht për verifikimin e nënshkrimeve të babait të kërkuesit në aktet e njoftimit, për të cilat kërkuesi ka pretenduar se janë të falsifikuara dhe të veprimeve të kryera nga përmbaruesi gjyqësor, si dhe ka urdhëruar prokurorinë të vazhdojë hetimet, të cilat duhet të përfundonin brenda dy muajve nga çasti i marrjes dijeni me vendimin e arsyetuar.

4. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezulton se çështja është transferuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë *(Prokuroria e Tiranës)*, për hetimin për veprat penale "Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën", të parashikuar në nenin 135 të KP-së, dhe "Falsifikimi i dokumenteve" të parashikuar në nenin 186 të KP-së, të pretenduara të kryera nga përmbaruesi gjyqësor, pasi ai ushtronte detyrën në Tiranë.

5. Prokuroria e Tiranës ka regjistruar procedimin penal nr. 5933 të vitit 2019 *(procedimi penal nr. 5933/2019).* Pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria e Tiranës ka paraqitur kërkesë për pushimin e procedimit penal, për shkak se kërkimet lidheshin me

falsifikimin e dokumenteve nga përmbaruesi gjyqësor, fakt i kualifikuar sipas nenit 186 të KP-së, dhe në referim të nenit 66 të KP-së afati i parashkrimit të ndjekjes penale për këtë vepër penale është 10 vjet, ndaj ndjekja penale ishte parashkruar. Ndërsa për veprat e tjera, fakti penal nuk ekzistonte. Gjithashtu, sipas Prokurorisë së Tiranës ekziston edhe një proces civil, në të cilin Gjykata e Apelit Vlorë i ka cilësuar të vlefshme procedurat e njoftimit të palës debitore/kërkuesit.

6. Për kërkesën e Prokurorisë së Tiranë, për pushimin e procedimit penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5710 regj.them., datë 01.07.2020, ka vendosur kthimin e akteve asaj prokurorie dhe vazhdimin e hetimeve të mëtejshme brenda afatit 90-ditor. Sipas gjykatës së shkallës së parë, edhe pse Prokuroria e Tiranës ka pyetur kërkuesin dhe personat e tjerët ndaj të cilëve drejtohej kallëzimi, si dhe ka marrë kopje të dosjes së përmbarimit, përsëri nuk ka kryer veprime hetimore për ekzistencën ose jo të veprave penale të kallëzuara.

7. Pas ankimit të Prokurorisë së Tiranës, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 2208, datë 20.12.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 5710 regj.them., datë 01.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e ankimit të prokurorisë. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. 5933/2019 të Prokurorisë së Tiranës, të regjistruar për veprat penale "Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën", "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuara nga nenet 135, 186 dhe 248 të KP-së. Sipas gjykatës së apelit, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" nuk mund të ushtrohet ndjekja penale për shkak të parashkrimit, ndërsa për veprat e tjera "Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën" dhe "Shpërdorimi i detyrës" ajo gjykatë ka arsyetuar se nuk mund të bashkekzistojnë të dyja, pasi përmbaruesi gjyqësor nuk është personi që ka për detyrë të ruajë e të administrojë pasurinë, dhe nuk ekziston fakti që në rastin konkret përmbaruesi të ketë përvetësuar sendin në favor të tij, ndaj nuk ekziston subjekti i veprës penale. Për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, sipas gjykatës së apelit rezulton se përmbaruesi ka kryer procedurat në përputhje me ligjin, pretendimet janë të natyrës civile dhe se janë shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, vendimi i së cilës është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë. Ndaj vendimit ka ushtruar rekurs kërkuesi dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1842, datë 02.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale *(KPP).*

8. Në datën 19.05.2026 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të

Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur rolin e saj si gjykatë ligjit. Ajo, e ndodhur mes dy vendimeve diametralisht të kundërta, duhet të analizonte se përse vendimi i gjykatës së apelit ishte i mbështetur në ligj.

9.1.2. *Parimit të barazisë së armëve,* pasi argumentet dhe provat e kërkuesit nuk janë trajtuar njësoj si ato të organeve proceduese. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë pranuar pa verifikuar konkluzionet e prokurorisë. Edhe Gjykata e Lartë i ka konsideruar veprimet e prokurorisë të rregullta dhe të ligjshme, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuesit.

9.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme,* pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë shqyrtuar, analizuar dhe vlerësuar pretendimet e ngritura nga kërkuesi, ndërkohë argumentet e prokurorisë janë konsideruar të mirëqena. Duke vepruar me këto standarde gjykatat e zakonshme kanë mbajtur haptazi një qëndrim të njëanshëm, jo objektiv dhe jo ligjor.

9.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs, megjithëse të listuara dhe të parashtruara në pjesën hyrëse të vendimit. Arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë është i paqartë dhe jokoherent. Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje kërkimit për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

9.1.5. *Gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm,* pasi çështja është regjistruar në gjykatën e apelit në vitin 2020 dhe ajo e ka shqyrtuar çështjen 3 vjet më vonë duke tejkaluar afatin 15-ditor të parashikuar në KPP. Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kritereve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Kolegji thekson se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial.

13. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna gjatë procesit gjyqësor penal, ku në përfundim të të cilit është vendosur lënia e fuqi e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal. Për rrjedhojë, kërkuesi, në aspektin procedural, legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë/kallëzues në procesin e kundërshtuar.

14. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimimit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29,*

datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues dhe faktin se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real. Nisur nga kjo, duke mbajtur parasysh faktet dhe natyrën e kësaj çështjeje, në vijim do të verifikohet, fillimisht, se cila e drejtë kushtetuese substanciale e kërkuesit vihet në diskutim në këtë rast dhe, në vijim, nëse vendimet e kundërshtuara të gjykatave janë ato që kanë ose mund të sjellin pasojat negative për atë të drejtë. Në këtë mënyrë do të vlerësohet nëse kërkuesi ka statusin e viktimës në raport me vendimet gjyqësore të kundërshtuara, për rrjedhojë nëse ai legjitimohen *ratione personae* për të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

15. Procesi gjyqësor objekt i ankimit kushtetues individual ka të bëjë, në thelb, me kundërshtimin e vendimit të pushimit të procedimit penal për kallëzimin e bërë nga kërkuesi ndaj veprimeve të kryera nga përmbaruesi gjyqësor për vënien në ekzekutim të procedurave si pasojë e mosshlyerjes së kredisë së marrë nga ai. Si pasojë e këtyre veprimeve, prona e lënë si kolateral u është nënshtruar procedurave të ankandit. Pas zhvillimit të procedurave, në ankandin e dytë, banka ka pranuar çmimin e vendosur dhe është kryer kalimi i pronësisë së pasurisë së paluajtshme në favor të saj (bankës). Vendimi i pushimit të procedimit penal është kundërshtuar nga kërkuesi dhe pas kthimit nga gjykata e shkallës së parë për plotësimin e hetimeve, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë konsideruar të drejtë vendimmarrjen e prokurorit, duke vlerësuar se vendimi ishte i argumentuar si në drejtim të plotësimit të afatit të parashkrimit, ashtu edhe në drejtim të mosekzistencën e fakteve penale dhe se veprimet juridike të kundërshtuara të përmbaruesit gjyqësor kishin natyrë juridike civile dhe nuk paraqisnin problematika të aspektit penal.

16. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se ndonëse në themel pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë kryesisht me të drejtën e pronës të lënë si kolateral për kredinë, të cilën e ka trashëguar nga ati i tij, procesi penal duket se nuk është rruga e vetme për rregullimin e pasojave materiale që ai synon, përveçse ky proces as nuk e kushtëzon në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave substanciale (civile), që ai pretendon se i janë shkelur. Nën këtë këndvështrim, procesi gjyqësor penal i kundërshtuar në gjykimin kushtetues nuk ndikon edhe në të drejtat civile që lidhen me mosmarrëveshjen për të drejtën e pronës dhe, në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk plotëson aspektin substancial të legjitimimit *ratione personae*. Në kushtet e mospërmbushjes së këtij kriteri, vlerësimi i kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet i panevojshëm, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.